



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.954/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada-Gllogjani kryesuese, Burim Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtar, duke vendosur lidhur me apelin e Kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit, Avdush Cakaj nga Subjekti Politik Demokratët për Drenasin, dega në Drenas paraqitur kundër vendimit me numer 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.11.2021 mori kete ;

V E N D I M

Hudhet i parregullt apeli Anr.954/2021, i datës 04.11.2021, i parashtruar nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit Avdush Cakaj nga Subjekti Politik Demokratët për Drenasin, dega në Drenas, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, PZAP-i, ka pranuar një apel të parashtruar nga Kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Drenasit, Avdush Cakaj nga Subjekti Politik Demokratët për Drenasin, dega në Drenas. Në apelin e tij parashtruesi ka theksuar se ju kanë keqpërdorur votat dhe kërkon rinumrimim të votave në këto vendvotime, Nekoc nr.vendvotimit 0310e/kl01R-02R/03D, Kizhnarek nr i vendvotimit 0321E/kl01R-02D, Llapushik nr. vendvotimit 0317E kl01R-03R-04-D, Komoran nr. Vendvotimit 0302Ek02R-03-05D. Parashtruesi i apelit si dëshmi ia ka bashkangjitur emrat e dëshmitarve që e kanë votuar dhe numrat e telefonit të tyre, por nuk e ka nënshkruar formularin e apelit.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së apelit gjeti se:

Apeli është i parregullt

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoi se apeli i paraqitur nga Avdush Cakaj, është i parregullt, sepse apeli në fjalë nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: “*Personi që e dorëzon apelimin duhet të përdorë formularin e gatshëm për apelim*”. Të gjitha apelimet duhet të kenë së paku informacionet vijuese:

- a) emrin, adresën dhe informacionet per kontaktim të personit që e dorëzon apelimin
- b) arsyen për dorëzimin e apelimt.
- c) hollësi rreth çfardo dëshmie dhe kopje të çfardo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzimin se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të parashtruesit të apelimt.
- d) vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimt.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëcekur.

Nga arsyet e lartëcekura e në mbështetje të nenit 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.954/2021 më datën 06.11.2021.

Kryetrosja e Panelit
Afijete Sada Glllogjani



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimt të këtij vendimi.